



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.1, datë 10.02.2026

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “LULEZIM PEPA” P.F, ME
VENDNDODHJE: RRUGA “FOTO XHAVELLA”, BASHKIA TIRANË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime të ndryshme, të subjektit “Lulezim Pepa” P.F, me vendndodhje: Rruga “Foto Xhavella”, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (pus-shpimi):

- X= 481561.8
- Y= 4577229.8
- Z= 84 m
- Sasia e ujit që jepet në përdorim : Q= 0.2 l/sek

- Qëllimi i përdorimit të ujit: Për larje automjesh.
- Thellësia e pus-shpimit: 150 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 50 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

X= 481541.921;

Y= 4577228.552;

Z= 83.5 m

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.2$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

ADRIAN GURRA

